



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Në bazë të paragrafit 6 te nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) lidhur me paragrafin 63.1.2 të Rregullores 01/2022 për Prokurimit Publik lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 04.01.2023 të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Triangle” SH.P.K. nga Suhareka, bie këtë :

VENDIM

I

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik “Triangle” SH.P.K. nga Suhareka e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 03.06.2023 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-23-2086-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-007-1-2-1 me titull: “**Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse**”

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “Triangle” SH.P.K. nga Suhareka me datë 03.06.2023 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: “**Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse**”

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 6; 7; 59; 60 dhe 61 të LPP-s si dhe është cekur se janë shkelur dispozitat përkatëse të pa specifikuar të RrUOP (i cili tanimë nuk është në fuqi që nga data 01.11.2022). Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s dhe rregullores, janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Në pretendimin e parë të paraqitur në kërkesën për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik ankues, është cekur se Operatori Ekonomik ankues ka ofruar tender të përgjegjshëm me çmimin më

të ulët, ndërsa ne si Autoritet Kontraktues kinse e kemi eliminuar në mënyrë të kundërligjshme. Është fakt se O.E. ankues i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, mirëpo sikur kemi cekur në letrën standarde për refuzim të tenderit, Komisioni vlerësues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit të paraqitur nga Operatori Ekonomik "Triangle" SH.P.K. duke u bazuar në rregullat për Prokurimin Publik nr.001/2022 në dispozitat për tenderët jo normalisht të ulët, konstatoi se ky O.E. në disa artikuj ka ofruar tender jo normalisht të ulët në krahasim me objektin e kontratës, ndërsa në disa artikuj tjerë ka ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut.

Komisioni duke u bazuar në nenin 61 të LPP-s ka kërkuar sqarim nga O.E. dhe në afat të kërkuar ka pranuar sqarimet të cilat për komisionin, kanë qenë të pamjaftueshme dhe jo bindëse, pasi që nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara si referencat në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së çmimeve si dhe si dëshmi nuk ka dërguar kopje të faturave, pro-faturave apo të ofertave në të cilat evidentohen artikujt e cekur në kërkesën për sqarimin e tenderit me arsyetimin që dokumentet e kërkuara nuk mund të dërgohen pasi që ato janë konfidenciale mes O.E. dhe furnitorit dhe se është arsyetuar që për shkak që furnizohen me sasi të madhe gjatë vitit kanë rabat nga kompanitë furnizuese. Ndërsa si përparësi ka deklaruar se shumicën e materialeve i ka në stok por që nuk ka ofruar kurrfarë dëshmie për një gjë të tillë.

Duke u bazuar në Rregulloren për Prokurimin Publik, dispozitat për tenderët Jo-normalisht të ulët, komisioni konstatoi se Operatori Ekonomik "TRIANGLE" SH.P.K. ka ofruar tender jo normalisht të ulët pasi që i ka përmbushur të gjitha kushtet e parapara në nenin 41 paragrafi 41.1 pika i. ii. iii. pasi që janë dorëzuar tre tenderë, tenderi i dorëzuar nga Operatori Ekonomik "TRIANGLE" SH.P.K. ka qenë më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm dhe çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët.

Andaj, në bazë të nenit 61 të LPP-s, Rregullores për Prokurimin Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 Paragrafët 41.8 dhe 41.10 pika b është kërkuar sqarim nga Operatori Ekonomik, por që nuk ka dhënë ndonjë sqarim në lidhje me ekonominë e procesit të shërbimeve, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin e O.E. për ekzekutimin e projektit që është duke u prokuruar. Gjithashtu nuk ka dhënë, informata shtesë mbi koston e shërbimeve të propozuara, por vetëm është zotuar dhe ka pranuar që do ta respektoj kontratën dhe se pasi që në disa artikuj ka dhënë çmimin jo normalisht të ulët dhe në disa artikuj çmime tepër të larta, ka llogaritur që deri në përfundim të kontratës çmimet e ulëta të mbulohen nga çmimet tepër të larta dhe se oferta është llogaritur në tërësi dhe jo për artikuj. Prandaj duke marrë parasysh se shpjegimi nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe bindës, si dhe O.E. nuk ka ofruar referencat në të cilat i ka bazuar çmimet e ofruara, tenderi i është refuzuar.

Në përshkrimin e çmimeve Autoriteti Kontraktues, shprehimisht e ka cekur se Operatorët Ekonomik me çmime jo normalisht të ulët dhe ata që ofrojnë çmime të larta të cilat nuk përkojnë me çmimet e tregut do të eliminohen automatikisht gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Edhe përkundër vërejtjes O.E. ankues ka vendosur çmime manipulative duke përzgjedhur artikujt për të cilët mendon që AK do të bëjë porosi më të shpeshta e për të cilat ka vendosur çmime tepër të larta, ndërsa për artikujt për të cilat kanë menduar që nuk do të porositen ka vendosur çmime tepër të ulëta.

Gjithashtu është fakt se O.E. është deklaruar në lidhje me rritjen e sigurimit të ekzekutimit sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, mirëpo për shkak se nuk ka ofruar sqarime në pikat tjera, është konsideruar që sqarimet janë të pa mjaftueshme pasi që nuk ka ofruar kurrfarë dëshmie e cila arsyeton ofertën jo normalisht të ulët në disa pozicione si dhe çmime tepër të larta në disa pozicione tjera.

Më tej O.E. ankues pretendon se është bërë vlerësim diskriminues pasi që edhe O.E. i rekomanduar ka ofruar disa pozicione me çmime të larta. Dhe ka bërë disa krahasime me tenderë tjerë të shpallur nga ana jonë në të kaluarën nga ku shihet çartë që i është qasur gabimisht vlerësimit në fjalë, pasi që për procedurat për të cilat është deklaruar në kërkesën për rishqyrtim, është zbatuar me përpikëri legjislacioni në fuqi i prokurimit publik. Pra edhe në rastet e cekura është kërkuar sqarim dhe AK ka pranuar informatat e kërkuara. Ndërsa vitin e kaluar për procedurën e njëjtë ne si AK kemi shpallur tender në të cilin ka marrë pjesë edhe O.E. i rekomanduar “Bajram Ha. Gashi” B.I. të cilit i është refuzuar oferta për shkak se vitin e kaluar kishte ofruar çmime tepër të larta në disa pozicione si dhe çmime tepër të ulëta në pozicione tjera, pra ngjashëm me O.E. ankues për këtë procedurë të prokurimit. Andaj konsiderojmë që pretendimet e O.E. ankues janë të pa baza.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-së, konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë pasi që ne të gjithë pjesëmarrësit i kemi trajtuar në mënyrë të barabartë pa kurrfarë diskriminimi dhe procedurën e hapur për prokurimin në fjalë e kemi udhëhequr në mënyrë transparente në përputhje të plotë me legjislacionin e prokurimit në fuqi. O.E. ankues ka kërkuar qasje në dokumentet e tenderit në fjalë dhe ne kemi qenë transparent duke ia ofruar qasjen e pa penguar për të gjitha dokumentet të cilat i ka kërkuar në përjashtim të dokumenteve për të cilat O.E. kanë bërë kërkesë për sekret afarist. Nga procesverbali i qasjes në dokumentacionin e këtij tenderi shihet se përfaqësuesi i O.E. ankues nuk ka pasur asnjë vërejtje në lidhje me qasjen, gjithashtu të gjitha dokumentet e procedurës janë ngarkuar në platformën e-prokurimi dhe në ueb-faqe të Komunës së Mamushës, andaj është për tu habitur pretendimi i O.E. ankues se procedura nuk është zhvilluar në mënyrë transparente!

Aktiviteti i prokurimit është udhëhequr në përshtatje të plotë me dispozitat e nenit 4 paragrafi 4.3 të Rregullores për prokurimin publik 001/2022 të cilat parashohin:

Citat: “Të gjitha aktivitetet e prokurimit do të udhëhiqen në pajtim me parimet bazike si në vijim:

- a. Konkurrenca – në mesin e Operatorëve Ekonomik duhet të inkurajohet në mënyrën më efikase dhe me efektive.
- b. Efikasiteti & Efektiviteti – duhet të dëshmohet në procesin e prokurimit për të siguruar vlerën për paranë për Autoritetin Kontraktues.
- c. Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmangët çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial.
- d. Objektivitet/Integritet/Sinqeritet – Të deklarohet çdo konflikt i interesit që afekton ose paraqet afektim të vendimit; Të refuzohen dhurata, mikpritje dhe benefit të çfarëdo lloji nga Operatori

Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial, të cilat mund të paraqesin kompromitim të objektivitetit ose integritetit.

e. Transparenca – Të sigurohen kushte dhe qasje të barabartë për të gjithë OE-të, duke informuar ata në mënyrë të hapur dhe transparente.

f. Llogaridhënie – Të ketë llogaridhënie për përgjegjësitë e përcaktuara, si dhe për vendimet e nxjerra, dhe regjistrimin e të dhënave të nevojshme.

g. Profesionalizëm – Të punohet me standarde të larta profesionale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke aplikuar praktikat më të mira.”

Sikur shihet në kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga ana e O.E. ankues, i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi apo fakt të vetëm i cili do të dëshmonte shkelje të dispozitave të lartcekura, andaj konsiderojmë që edhe ky pretendim është i pa bazë.

Operatori Ekonomik ankues ka pretenduar se janë shkelur edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së. Edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm, pasi që ne si Autoritet Kontraktues i kemi respektuar të gjitha dispozitat ligjore të legjislacionit të Prokurimit Publik. Për tu siguruar që kjo procedurë të zhvillohet në mënyrën më efikase. Gjithashtu gjatë kësaj procedure, janë zbatuar të gjitha parimet e LPP-s dhe është marrë për bazë parimi i shfrytëzimit të drejtë të fondeve publike, duke u kujdesur që të marrim vlerën për paranë, pasi që kemi pranuar oferta në të cilat në shumë pozicione janë ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut sikur kemi shpjeguar më lartë. Pra qëllimi i LPP-s është që të mbrohet buxheti i shtetit duke siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Republikën e Kosovës. Andaj na del se ne si AK nuk i kemi shkelur dispozitat e nenit 1 të LPP-s por i kemi respektuar me përpikëri dispozitat në fjalë. Ndërsa O.E. ankues duke vendosur çmime të larta me pretendimin se çmimi i vendosur është llogaritur në tërësi të tenderit dhe jo për artikuj, është në kundërshtim të dispozitave të nenit 1 të LPP-s pasi që nuk përshtatet me qëllimin e LPP-s për të siguruar vlerën për paranë.

Më tej O.E. ankues pretendon që janë shkelur edhe dispozitat e nenit 59 të LPP-s për shkak që sipa O.E. ankues, është rekomanduar për dhënie një O.E. i pa përgjegjshëm me arsyetimin që afati i liferimit nuk është dorëzuar në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit. Komisioni vlerësues në raportin e vlerësimit ka konstatuar që O.E. i rekomanduar ka dorëzuar afatin e liferimit në të cilin ka marrë përgjegjësi që do të respektojë afatin e liferimit prej pesë (5) ditëve nga data e porosisë sikur është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë dhe të njëjtin e ka nënshkruar dhe vulosur. Edhe O.E. ankues e ka vërtetuar një gjë të tillë në kërkesën për rishqyrtim në të cilën e ka bashkangjitur edhe dokumentin në fjalë.

Gjithashtu pretendon që O.E. i rekomanduar nuk ka dorëzuar aneksin 1 të Dosjes së Tenderit gjë e cila nuk është e vërtetë pasi që në dosje të tenderit tek Seksioni II. FLETA E TË DHËNAVE TË TENDERIT (FTD) në nenin 3.1 është paraparë kërkesa si vijon: Operatori ekonomik me tenderin e tij duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë:

Deklaratën për specifikacionet teknike për furnizimet (materialet) e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (Të plotësohet, nënshkruhet dhe vuloset aneksi nr. 7 i kësaj dosje të tenderit). Operatori Ekonomik i rekomanduar me tenderin e tij e ka dorëzuar të

plotësuar, të vulosur dhe të nënshkruar aneksin nr. 7 me të cilin ka deklaruar që do t'i përmbahet specifikacionit teknik të kërkuar në aneksin nr. 1 Me rastin e qasjes në dokumentet e tenderit në fjalë ky dokument i është dhënë O.E. ankues. Andaj konsiderojmë që ky pretendim është i pa bazë.

Më tej O.E. ankues pretendon që lista e pajisjeve të paraqitur nga ana e O.E. të rekomanduar nuk e plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues pasi që nuk ka ofruar informacione për gjendjen e pajisjeve të specifikuara në aneksin nr. 8 të dosjes së tenderit. Gjatë vlerësimit të tenderit në fjalë, komisioni ka konstatuar që O.E. e ka dorëzuar listën e pajisjeve si dhe e ka plotësuar edhe aneksin nr. 8 të dosjes së tenderit si dhe ka dorëzuar dëshmitë për pajisjet e kërkuara, në përjashtim të pajisjes kompresor për shpuarje të cilin e ka paraqitur në listën e projekteve por për të cilin nuk ka ofruar dëshminë. Andaj duke u bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-s dhe në nenin 10 të Udhëzuesit të Prokurimit, kemi kërkuar sqarim nga O.E. i rekomanduar i cili i është përgjigjur kërkesës tonë dhe përmes platformës na ka dërguar dëshmitë e pajisjes në fjalë në bazë të të cilave është vërtetuar që ky O.E. e posedon një pajisje të tillë të cilën e kishte blerë para datës së publikimit të njoftimit për kontratë.

Sa i përket dëmeve materiale për të cilat O.E. pretendon se i janë shkaktuar, në dosje të tenderit shprehimisht është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre. O.E. ankues ka paraqitur si shpenzim shërbimet e avokatisë, mirëpo sikur shihet në ankesë nuk ka angazhuar asnjë avokat. Gjithashtu ka kërkuar fitimin e humbur mirëpo ne nuk kemi pasur kontratë me këtë O.E. dhe e njëjta nuk ka qenë duke ekzekutuar punët në mënyrë që të humb fitimin për shkak të Autoritetit Kontraktues. Pra edhe ky pretendim është i pa bazuar.

Andaj,

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 06.06.2023

Gazmend Gashi
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit
Komuna Mamushë



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.